

Specialist në Sektorin e Fotogrametrisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 04 datë 08.01.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Fotogrametrisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Ndjekjen etë gjitha punimeve që lidhen me zyrtarizimin dhe zbatimin e standardeve të BE-së, në krijimin (3D), ruajtjen e materialeve dhe të dhënave hartografike bazë me metodën fotogrametrike, që lidhen me krijimin e hartës bazë të unifikuar në Republikën e Shqipërisë, sipas temave të përcaktuara në ligjin nr. 72/2012;
2. Përdorimin e infrastrukturës dhe teknologjisë fotogrametrike (3D), me qëllim rievimin fotogrametrik dhe krijimin e informacionit hartografik në përputhje me kërkesat e hartës bazë (1:500-1:5000);
3. Krijimin, ndjekjen dhe kontrollin e të gjitha punimeve që lidhen me projektimin, krijimin dhe përditësimin e hartave topografike të shkallëve të ndryshme dhe hartave të tjera me metodën e fotografimit ajror të territorit, ortoimazherinë dhe krijimin e Modelit Dixhital të Terenit (DTM) të vendit;
4. Përdorimin e të dhënave që merren nga shërbimet satelitore si informacion për temat që parashikon ligji nr. 72/2012;
5. Përdorimin, ruajtjen dhe përditësimin e programet ve fotogrametrike (me sektorin e IT) në funksion të politikave të licensimit si dhe informacionin sipas tematikës që lidhet me temat e parashikuara në ligji nr. 72/2012;
6. Propozimin dhe pjesëmarrjen në hartimin e Draft/akteve-nënligjore/udhëzuesve të nevojshëm që lidhen me zhvillimin SW dhe HW, metodikën e krijimit të hartës bazë, kadastrale multifunkionale të vendit, e cila do të shërbejë si baza unike e të gjitha GIS-eve të tematikave të ndryshme përcaktuar në ligjin nr. 72/2012 dhe që mbulojnë territorin e vendit;

7. Mbledhjen e të dhënave lidhur me punimet rievuese hartografike që kryhen në territorin e vendit, analizimin, përditësimin dhe propozimin mbi aksesueshmërinë nga subjektet e interesuara nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar;
8. Përdorimin e të dhënave nga fotografimet ajrore të reja, UAV dhe atyre që merren nga shërbimet satelitore si informacion, shtesë për temat që parashikon ligji nr. 72/2012;
9. Identifikimin e nevojave dhe ofrimin e propozimeve për akte të nevojshme nënligjore që lidhen me aktualizimin e rregullave, saktësive, procedurave dhe dokumentimin e punimeve në fushën e krijimit të informacionit hartografik nga përvoja ndërkombëtare dhe situata brenda vendit;
10. Ndjekjen dhe zbatimin e detyrave sektoriale të dhëna nga eprori;
11. Kryerjen dhe kontrollin e çdo punimi në mënyrë që produkti të jetë në përputhje me kërkesat teknike dhe saktësitë e miratuara në kuadrin ligjor në fuqi;
12. Referimin e çdo problematike të identifikuar gjatë procesit të punës dhe bën rekomandimet përkatëse;
13. Menaxhimin e bazës së të dhënave të mbledhur nga autoritetet publike apo palët e treat dhe çdo produkt tjetër lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori;
14. Përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit dhe sipas rëndësisë dhe Drejtorin e Drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti problematikat e hasura gjatë punës së tij;
15. Kryerjen e çdo funksioni të ngarkuar nga eprori, për realizimin e veprimtarisë së sektorit dhe ASIG;
16. Kontrollin dhe përpunimin e çdo produkti të marrë nga autoritetet palë në këtë proces;
17. Përfaqësimin e institucionit në takime pune dhe konferenca lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori, sipas propozimit të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratimit të Drejtorit të Përgjithshëm.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë diplomë “Master profesional”, diplomuar në Gjeodezi/Gjeoinformatikë/Markshajderi/Planifikim territori dhe GIS;
2. Të këtë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse;
3. Të këtë njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;
4. Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet;
5. Të këtë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me proceset e domosdoshme nëpër të cilat kalon krijimi i hartës në përgjithësi dhe i hartës bazë, ortoimazherisë dhe Modelit Dixhital të Terrenit në veçanti;

6. Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me projeksionet e ndryshme hartografike dhe veçanërisht UTM, TMzn, Gaus-Kryger etj;
7. Të njohë programet kompjuterike fotogrametrike digjitale bazë Info datem, ArcGis Stero dhe fotogrametria analitike, si dhe AutoCAD, ArcGIS Desktop, ArcGIS Server, PostgresSQL, PostGIS, Enterprise Architect, Quantum GIS, Openlayers, Mapserver, Word, Excel and Access;
8. Të ketë njohuri të thelluara lidhur me shenjat konvencionale që përdoren në vend dhe në vendet e BE-së;
9. Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit hartografik nga një referencë gjeodezike në një tjetër;
10. Njohuri të legjislationit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor;
11. Aftësi të mira komunikimi, propozim dhe menaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi, aftësi për të suportuar kryerjen e punimeve hartografike me standarde të nivelit që kërkon integrimi europian i vendit, aftësi për të menaxhuar një grup ose grupe ekspertësh dhe aftësi për të qënë lider i grupit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 15.08.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit burime.njerezore@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja (nëse ka)
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Pas datës 15.08.2024, aplikantët të cilët kalojnë fazën e parë të vlerësimit, do të njoftohen me e-mail për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.